



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

PROJEKT VENDIM

Nr. _____, datë _____, 2026

PËR

**PËRBËRJEN, FUNKSIONIMIN, DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË E
ANËTARËVE TË MEKANIZMIT TË KOORDINUAR TË REFERIMIT TË
RASTEVE TË DHUNËS NDAJ GRAVE DHE DHUNËS NË FAMILJE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 56, të ligjit nr. 11/2026, "Për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje", me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

KREU I

• **DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

Neni 1

Objekti

Ky vendim ka për objekt:

1. Të përcaktojë rolin, përbërjen, funksionimin dhe përgjegjësitë e mekanizmit të koordinuar të referimit të rasteve të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje (MKR) që vepron pranë çdo bashkie, me qëllim parandalimin dhe trajtimin e tyre.
2. Të përcaktojë autoritetet në nivel vendor pjesë e MKR-së.
3. Të përcaktojë procedurat standarde bazë për bashkërendimin dhe koordinimin e punës ndërmjet autoriteteve përgjegjëse si pjesë e MKR-së.

Neni 2

Qëllimi

Ky vendim ka për qëllim:

1. Parandalimin, mbrojtjen, mbështetjen, rehabilitimin dhe riintegrimin e viktimave të të gjitha formave të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, nëpërmjet krijimit të një rrjeti të koordinuar institucionesh përgjegjëse në nivel vendor, si dhe organizatave të shoqërisë civile, me qasje të integruar dhe me në qendër viktimën;

2. Bashkëpunimin dhe koordinimin efektiv midis të gjithë aktorëve që janë pjesë e MKR-së në nivel vendor;
3. Ndërveprimin e autoriteteve në nivel vendor si pjesë e MKR-së me autoritetet qendrore dhe me subjektet e tjera, me qëllim garantimin e zbatimit në tërësi të legjislacionit në fuqi "Për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje" për detyrat që lidhen me fushën e veprimtarisë të tyre.
4. Marrjen e masave për një qasje të integruar dhe me në qendër viktimën e të gjitha formave të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, duke garantuar të drejtat e njeriut e promovuar barazinë gjinore, si dhe duke eliminuar të gjitha format e diskriminimit ndaj grave.

Neni 3 Përkufizime

1. Termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:
 - a) "Koordinator/e vendor për referimin dhe menaxhimin e rasteve të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje" (KV) - punonjës/e pranë bashkisë, përgjegjës për referimin dhe menaxhimin e rasteve të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje;
 - b) "Mekanizëm i Koordinuar i Referimit të rasteve të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje" (MKR) - rrjeti i organizuar i institucioneve përgjegjëse në nivel vendor për parandalimin, mbrojtjen, mbështetjen me shërbime, rehabilitimin dhe riintegrimin e viktimave të të gjitha formave të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje;
 - c) "Menaxhim i rastit të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje"- veprimtaria efektive që siguron ndihmën dhe mbështetjen e personave të dhunuar, me qëllim mbrojtjen, garantimin e të drejtave, rehabilitimin dhe riintegrimin e tyre;
 - d) "Njësia e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit" (NVNR) - njësi e krijuar sipas nevojës pranë bashkisë ose njësive administrative që ka në përbërje, por pa u kufizuar, punonjësen/in social, punonjësen/in e mbrojtjes së fëmijës, si dhe administratoren/in shoqëror, dhe që ka për detyrë, ndër të tjera, vlerësimin fillestar të nevojave dhe të rrezikut, hartimin e planit individual të përkujdesit dhe mbështetjes, si dhe mbrojtjen e përkujdesjen ndaj çdo individi në nevojë;
 - e) "Plan i përbashkët i ndërhyrjes" (PPN) - plani i hartuar nga anëtarët/ët e ETN-së dhe KV-ja lidhur me koordinimin ndërinstitutional për zgjidhjen afatgjatë të rastit të trajtuar, mbështetur edhe në masat mbrojtëse të vendosura në UMM/UM përfshirë vlerësimin individual sipas këtij vendimi dhe akteve nënligjore në fuqi;
 - f) "Rast urgjent" - rasti kur dhuna e ushtruar paraqet nivel të lartë të rrezikut për jetën, shëndetin, mirëqenien dhe lirinë e personit dhe merren masa paraprake të menjëhershme për mbrojtjen e viktimave, si dhe për ndalimin e dhunës dhe përshkallëzimin e mëtejshëm të saj;
 - g) "Shporta e shërbimeve" - tërësia e shërbimeve që ofrohen në mënyrë të koordinuar nga institucionet anëtare të MKR-së në bashki për mbrojtjen e menjëhershme dhe afatgjatë të viktimës përfshirë por pa u kufizuar në shërbimet bazë si ato të lidhura me strehim të sigurt, ushqim e veshmbathje, ndihmë juridike, mbështetje psikologjike, shërbime përkthimi, shëndetësore, përshtatje të arsyeshme sipas

nevojave, si dhe shërbime rehabilituese e riintegruese, përfshirë fuqizimin ekonomik, transport të sigurt sipas nevojës, etj;

- h) “Riviktimizim” - shkaktimi në mënyrë të përsëritur i dëmtimeve të mëtejshme viktimës së dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje nga ana e dhunuesit, si pasojë e një veprimi që ka lidhje me raportimin/denoncimin e dhunës;
- i) “Vlerësimi individual” - procesi gjithëpërfshirës me në qendër viktimën, që synon identifikimin dhe vlerësimin e rrezikut aktual dhe potencial për sigurinë, jetën, integritetin fizik, psikologjik, seksual, social dhe ekonomik të viktimës së dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, si dhe të personave në varësi të saj. Ky proces përfshin përcaktimin e nevojave dhe të masave të menjëhershme për mbrojtje, mbështetje, rehabilitim dhe riintegrim, përfshirë hartimin e planit individual të përkujdesit dhe mbështetjes, planin e përbashkët të ndërhyrjes, sidhe referimin drejt shërbimeve të përgjithshme dhe shërbimeve mbështetëse të specializuara, në përputhje me udhëzimin e ministres apo ministrit përgjegjës për çështjet e barazisë gjinore dhe çështjet sociale.
- j) “Viktimizimi dytësor”- shkaktimi i një gjendjeje, që rëndon më tej dëmin e pësuar nga viktima e dhunës për shkak të raportimit, pjesëmarrjes në procedura ligjore dhe/ose gjyqësore, intervistimit të përsëritur nga një ose disa anëtarë të ETN, trajtimit të papërshtatshëm, fajësues, stigmatizues ose jo të ndjeshëm ndaj traumës nga institucionet dhe profesionistët apo profesionistët përgjegjës, nxitjes dhe/ose përfshirjes në zgjidhje me ndërmjetësim, si dhe çdo veprim apo mosveprim institucional që shkakton ritraumatizim, cenim të dinjitetit, humbje të besimit ose përkeqësim të gjendjes psikologjike, emocionale apo sociale të viktimës;
- k) “REVALB” - sistemi elektronik i regjistrimit dhe i ruajtjes së të dhënave për rastet e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje pranë bashkisë.

- 2. Në këtë vendim, termat e tjerë të përdorur kanë të njëjtin kuptim me përkufizimet e dhëna në legjislacionin në fuqi për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje, që për lehtësi përfshihen edhe në Shtojcën 1 të këtij vendimi.

Neni 4

Përbërja e Mekanizmit të Koordinuar të Referimit

- 1. MKR-ja krijohet pranë çdo bashkie me qëllim parandalimin, trajtimin dhe riintegrimin e të gjitha rasteve të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje.
- 2. MKR-ja e përbëhet nga:
 - a) komiteti drejtues për bashkërendimin e veprimtarisë së institucioneve të autoriteteve përgjegjëse, në nivel vendor, dhe referimin e rasteve të dhunës (në vijim KD);
 - b) ekipi teknik ndërdisiplinor (në vijim, ETN);
 - c) koordinatorja/i vendor (në vijim, KV).
- 3. Adresa zyrtare e MKR-së është ajo e KV pranë bashkisë përkatëse.

Neni 5

Parimet e veprimtarisë së Mekanizmit të Koordinuar të Referimit

1. Parimet kryesore të veprimtarisë së MKR-së bazohen në legjislacionin në fuqi për prandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje dhe ato të barazisë gjinore me fokus:
 - a) qasjen me në qendër viktimën duke i dhënë përparësi respektimit të dinjitetit, të drejtave, sigurisë, mbrojtjes, mirëqenies, pjesëmarrjes aktive të viktimës në vendimmarrje, duke siguruar mbështetje me informacionin e duhur dhe pa paragjykime, duke shmangur viktimizimin dytësor përfshirë shmangien e intervistimit të përsëritur të viktimës dhe realizimin e intervistës mundësisht vetëm një herë, si dhe duke e vendosur autorin përpara përgjegjësisë;
 - b) mosjustifikimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje;
 - c) trajtimin e barabartë dhe pa diskriminim të viktimave të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje;
 - d) trajtimin efektiv dhe përkujdesjen individuale sipas nevojave të viktimës;
 - e) respektimin e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale dhe privatësisë;
 - f) ofrimin e shërbimeve lehtësisht të aksesueshme, të arritshme dhe falas sipas legjislacionit në fuqi;
 - g) mbështetjen dhe partneritetin ndërinstytucional dhe me aktorët e shoqërisë civile;
 - h) parimin sipas të cilit barra e provës për të vërtetuar se faktet e pretenduara nuk përbëjnë dhunë apo ngacmim i takon të paditurit;
 - i) ndalimin e çdo procedure të detyrueshme alternative të zgjidhjes së konflikteve ndërmjet viktimës dhe autorit të dhunës, duke përfshirë ndërmjetësimin dhe pajtimin;
 - j) Anëtarët e MKR-së ushtrojnë detyrat e tyre në përputhje me parimet e etikës profesionale, duke garantuar respektimin e dinjitetit dhe të drejtave të viktimave.

KREU II

PËRBËRJA, DETYRAT DHE FUNKSIONIMI I KOMITETIT DREJTUES

Neni 6

Rregulla të përgjithshme

1. Komiteti Drejtues (KD) për bashkërendimin e veprimtarisë së institucioneve të autoriteteve përgjegjëse në nivel vendor dhe referimin e rasteve të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje krijohet dhe funksionon pranë çdo bashkie.
2. KD përbëhet nga anëtar/e të përhershëm si dhe *ad hoc* të cilët ftohen të marrin pjesë sipas rastit, në varësi të çështjeve të rendit të ditës.
3. Anëtarët/ët e KD përbëhen nga përfaqësueset/it e institucioneve sipas kësaj VKM-je në nivele drejtuese.
4. Përcaktimi i anëtareve/ëve të KD, për sa është e mundur, mbështetet mbi parimet e përfaqësimit të barabartë gjinor.

Neni 7
Përbërja e Komitetit Drejtues

1. Kryetarja/i e/i Bashkisë drejton veprimtarinë e KD dhe e përfaqëson atë në marrëdhëniet me organet e pushtetit qendror dhe vendor.
2. Komiteti Drejtues ka në përbërje drejtues/e të institucioneve si më poshtë vijon:
 - a) Bashkia;
 - b) Policia e Shtetit;
 - c) Gjykata e Juridiksionit të Përgjithshëm;
 - d) Prokuroria e Juridiksionit të Përgjithshëm;
 - e) Zyra e përmbartimit shtetëror vendor;
 - f) Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar dhe/ose Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar;
 - g) Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor dhe/ose spitalet apo qendrat shëndetësore;
 - h) Drejtoria e Shërbimit Social pranë bashkisë;
 - i) Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror;
 - j) Prefekti i qarkut;
 - k) Këshilli i qarkut;
 - l) Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive dhe/ose Zyra Rajonale apo Vendore e Punësimit;
 - m) Organizata jofitimprurëse në fushën e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje;
 - n) Qendrat/strehëzat e ngritura për viktimat e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje në atë bashki ose në qarkun në juridiksionin e të cilit janë këto shërbime;
 - o) Qendra e rehabilitimit për dhunuesit;
 - p) Qendra e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore.
3. Nëse pranë bashkive nuk ka zyra të ndonjë prej institucioneve sipas pikës 1 të këtij neni, përfaqësues në KD është drejtuesja/i i këtij institucioni në nivel prefekturë.
4. Anëtarët/ët e përhershëm të KD sipas pikës 1, të këtij neni, mund të përfaqësohen, vetëm në raste përjashtimore, nga përfaqësues/e në nivel zëvendës drejtues/e, në rastet kur drejtuesja/i i institucionit nuk mund të jetë prezent për arsye të justifikuara.
5. KV-ja është anëtar/e në KD. Në rastet kur bashkia ka më shumë se një KV, kryetarja/i i bashkisë cakton KV-në si anëtar/e në KD.
6. Në mbledhjet e KD, në varësi të çështjeve të rendit të ditës, ftohen të marrin pjesë edhe drejtues/e nga institucionet si më poshtë vijon:
 - a) Qendra e Menaxhimit të Dhunës Seksuale;
 - b) Zyra Vendore e Shërbimit të Provës;
 - c) Dhoma Vendore e Avokatisë;
 - d) Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve;
 - e) Urdhri i Psikologut;
 - f) Urdhri i Punonjësit Social;
 - g) Njësia e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit (NJVNR);

- h) Kryetarja/i i fshatit;
- i) Mjekësia ligjore;
- j) Zyra Vendore e Migracionit;
- k) Mediat lokale;
- l) Institucionet e të drejtave të njeriut në nivel vendor si Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Avokati i Popullit;
- m) Dega vendore e partisë politike përkatëse në rastet e dhunës ndaj grave në proceset zgjedhore dhe në politikë;
- n) Institucionet fetare, që mund të ofrojnë shërbime për viktimat e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje;
- o) Shërbimet të tjera në nivel vendor me rëndësi për pjesëmarrje nisur nga çështjet e rendit të ditës;
- p) Përfaqësues/e të punëdhënësve dhe punëmarrësve në raste të dhunës dhe ngacmimit në punë;
- q) Drejtoria Rajonale e Inspektoriatit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore.

6. Sipas rastit, në varësi të çështjeve të rendit të ditës, në mbledhjet e KD ftohen të marrin pjesë specialiste/ë ose ekspert/e të çështjeve të lidhura me dhunën ndaj grave dhe dhunën në familje.

Neni 8

Përzgjedhja e Organizatave Jo-Fitimprurëse në Komitetin Drejtues

1. Kryetarja/i i bashkisë në bashkëpunim me drejtuesen/in e strukturës së shërbimeve sociale pranë bashkisë bën përzgjedhjen e Organizatave Jo-Fitimprurëse (OJF) pjesë e KD.
2. Përzgjedhja e OJF-ve bëhet sipas një procedure aplikimi të hapur dhe transparente, duke pasur në vëmendje, por pa u kufizuar në rolin dhe veprimtarinë e OJF-ve në çështje të dhunës ndaj grave, dhunës në familje, dhunës me bazë gjinore, diskriminimit, mbrojtjes së të drejtave të pakicave kombëtare ose në fusha të ngjashme.
3. Procedura e aplikimit, kriteret e përzgjedhjes dhe kohëzgjatja e përfaqësimit përcaktohen me vendim të kryetares/it të bashkisë duke mbajtur në vëmendje eksperiencën në çështje të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, si dhe kontributin në nivel komunitar.

Neni 9

Mbledhjet e Komitetit Drejtues

1. KD mbledhet dy herë në vit në mbledhje të zakonshme dhe sipas nevojave në mbledhje të jashtëzakonshme.
2. Të drejtën për të kërkuar mbledhjen e KD dhe përfshirjen e çështjeve në rendin e ditës, si dhe të ftuarve sipas nenit 7 të këtij vendimi e kanë kryetarja/i bashkisë ose jo më pak se tre anëtarë/ë.

3. Njoftimi për mbledhjen e zakonshme bëhet me shkrim, përfshirë këtu dhe dërgimin në adresën elektronike, të paktën 10 (dhjetë) ditë përpara datës së mbledhjes.
4. Në rastin e mbledhjeve të jashtëzakonshme njoftimi me shkrim bëhet të paktën 24 (njëzet e katër) orë përpara.
5. Në çdo rast, njoftimi për mbledhjen e KD përmban datën, orën, vendin dhe detaje për rendin e ditës.
6. Vendimet e KD me rëndësi për publikun, publikohen në faqen e internetit (*ëeb*) të secilës bashki.
7. KD merr vendime me shumicën e anëtareve dhe anëtarëve të pranishëm.
8. Për çdo mbledhje të KD mbahet procesverbal, i cili nënshkruhet nga kryetarja/i dhe nga përfaqësuesja/i që mban procesverbalin.
9. Gjatë zhvillimit të mbledhjeve të KD dhe trajtimit të çështjeve, respektohet konfidencialiteti dhe mbrojtja e të dhënave personale të viktimave, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 10

Detyrat e Komitetit Drejtues

1. Detyrat e KD në drejtimin e politikë-bërjes:
 - a) siguron mbështetjen e nevojshme institucionale dhe politike të MKR dhe ndjek zbatimin e detyrimeve dhe të politikave, që burojnë nga kuadri ligjor në fuqi lidhur me organet e vetëqeverisjes vendore për rastet e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje;
 - b) bën propozime dhe paraqet kërkesa pranë autoriteteve shtetërore përgjegjëse në nivel qendror dhe vendor për përmirësimin e trajtimit të rasteve, me fokus të veçantë grupet në situatë të cenueshme përfshirë gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara, gratë e minoriteteve, gratë nga komuniteti LGBTI+, gratë e moshës së tretë, vajzat-nëna dhe nënat kryefamiljare, gratë e zonave rurale, shtetas/e të huaj dhe/ose pa shtetësi duke adresuar nevojat e tyre specifike dhe format e diskriminimit të shumëfishtë e të ndërthurur;
 - c) miraton në parim marrëveshjet e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve shtetërore dhe subjekteve të tjera për realizimin e detyrave në funksion të zbatimit të legjislacionit në fuqi për masa ndaj dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje;
 - d) ndjek identifikimin e problemeve për dhunën ndaj grave dhe dhunën në familje në territorin e bashkisë/qarkut, brenda të cilit ushtrojnë kompetencat anëtarët/ët e KD;
 - e) bën planifikim të qendrueshëm vjetor të burimeve financiare dhe kostove si dhe bën orientimin e proceseve të buxhetimit të përgjigjshëm gjinor të anëtareve/ëve të KD me qëllim:
 - i) sigurimin e aksesit në shërbime të përgjithshme, të specializuara rehabilituese (afatmesme) dhe riintegruese (afatgjata) të lidhura me menaxhimin e rasteve përfshirë ato emergjente,

- ii) menaxhimin e duhur të rasteve emergjente duke parashikuar një fond të dedikuar dhe të aksesueshëm me procedurë të përshpejtuar nga ana e KV dhe/ose ETN përfshirë në të shpenzimet e menaxhimit, mjetet e domosdoshme të punës, shportën e shërbimeve dhe nevoja emergjente sipas rastit.
- iii) sigurimin e një fondi të dedikuar për shpenzimet e lidhura me mirëfunksionimin efektiv të KD, ETN dhe KV si dhe shpenzimeve të lidhura me administrimin e sigurt të dokumentacionit dhe të dhënave.
- f) monitoron funksionimin e MKR dhe zbatimin e detyrave nga institucionet dhe
- g) subjektet e përfshira, në përputhje me këtë vendim dhe legjislacionin në fuqi;
- h) analizon periodikisht të dhënat mbi rastet e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, përfshirë të dhënat e sistemit REVALB, me qëllim përmirësimin e politikave dhe ndërhyrjeve në nivel vendor;
- i) ësiguron që institucionet anëtare të MKR të përmbushin detyrimet e tyre në mënyrë
- j) të detyrueshme dhe në kohë, dhe, në rast moszbatimi, referon problematikën pranë autoriteteve përkatëse për marrjen e masave administrative ose disiplinore, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

2. Detyrat e KD në lidhje me shportën e shërbimeve përfshijnë:

- a) sigurimin e shportës së shërbimeve të detyrueshme, të standardizuar dhe të koordinuar mes anëtareve/ëve të MKR-së. Standardizimi i shërbimeve përfshin por pa u kufizuar listën e shërbimeve që çdo bashki garanton pa cenuar standardet bazë të tyre, aktorët e përfshirë në dhënien e tyre, mënyrën dhe protokollet e komunikimit mes aktorëve dhe me KV, afatet e reagimit, procedurat e referimit.
- b) marrjen e masave që shporta e shërbimeve të përmbajë shërbime emergjente dhe mbrojtëse, shërbime sociale, psikologjike, juridike, shëndetësore, shërbime për fëmijët e viktimave, si dhe shërbime të specializuara për kategori në nevojë.
- c) garantimin që paketa minimale e shërbimeve emergjente të përmbajë strehim 72-orë deri në vërtetimin e UMM, paketë ushqimore/higjienike, veshmbathje, paketë sipas nevojave shëndetësore, transport urgjent e të sigurt.

3. Detyrat e KD në lidhje me ndërgjegjësimin, edukimin dhe trajnimin përfshin:

- a) miratimin e planit vjetor të aktiviteteve, fushatave dhe takimeve ndërgjegjësuëse dhe edukuese për publikun si dhe publikimin e materialeve ndërgjegjësuëse dhe informuese;
- b) marrjen e masave për përgatitjen, orientimin dhe organizimin e fushatave dhe takimeve ndërgjegjësuëse mbi bazën e planifikimeve vjetore, si dhe hartimin, mbi baza vjetore, një listë me temat prioritare të trajnimit për strukturat vendore, bazuar në problematikën e evidentuara dhe format e reja të dhunës, sipas legjislacionit në fuqi;
- c) organizimin dhe orientimin e aktiviteteve për informimin qytetar mbi funksionimin e MKR dhe mënyrat raportimit dhe të kontaktit;

- d) kujdesin për rritjen profesionale të anëtareve/ëve të MKR dhe organizimin e trajnimeve të përbashkëta ndërdisiplinore për personelin që trajton çështjet e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje;
- e) informimin dhe monitorimin mbi baza vjetore të zbatimit të trajnimeve nga strukturat përgjegjëse të MKR të përshtatura sipas nevojave dhe rolit të tyre, me qëllim rritjen e kapaciteteve dhe specializimin e tyre në drejtim të menaxhimit, trajtimit dhe referimit të rasteve, si dhe zbatimit të vendimeve gjyqësore të UM/UMM, dhe ja paraqet këto të dhëna ministrisë përgjegjëse për çështjet e barazisë gjinore.

4. Detyrat e KD në drejtim të koordinimit dhe bashkëpunimit përfshijnë:

- a) masa për koordinimin ndërinstytucional të MKR-së;
- b) aktivizimin e individëve, të shoqërisë civile dhe të përfaqësuesve të njësisve administrative drejt bashkëpunimit dhe referimit të rasteve, duke garantuar fshehtësinë e të dhënave personale të viktimave të dhunës, si dhe të profesionisteve/ëve apo institucioneve dhe organizatave, që ofrojnë informacion për rastet;
- c) funksionimin efektiv të MKR dhe aksesin e viktimave në shërbime të përgjithshme dhe shërbime mbështetëse të specializuara, në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- d) miratimin e një instrument të unifikuar kombëtar për vlerësimin e rrezikut, i cili rishikohet periodikisht gjatë gjithë ciklit të menaxhimit të rastit, që zbatohet nga MKR;
- e) garantimin e aksesit efektiv të viktimave në mekanizmat e mbrojtjes dhe në sistemin e drejtësisë përmes koordinimit të tyre në përputhje me legjislacionin në fuqi.

5. Detyrat e KD në lidhje me ETN:

- a) miraton rregullat për funksionimin e ETN-së, protokollet për menaxhimin e rasteve dhe Procedurat Standarde të Veprimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- b) vlerëson punën e ETN-së bazuar në raportet periodike dhe informacionet e paraqitura, si dhe merr vendime për përmirësimin e funksionimit të tij;

6. Detyrat e KD në lidhje me të dhënat dhe statistikat:

- a) mbi baza vjetore, paraqet të dhëna administrative pranë autoriteteve përgjegjëse për përpunimin dhe publikimin e statistikave zyrtare për dhunën ndaj grave dhe dhunën në familje.
- b) analizon dhe ndjek problematikat që lidhen me menaxhimin e rasteve të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, bazuar në të dhënat e gjeneruara nga sistemi REVALB, me qëllim përmirësimin e ndërhyrjeve dhe shërbimeve në nivel vendor.

Neni 11

Detyrat e anëtareve dhe anëtarëve të Komitetit Drejtues

1. Pjesëmarrja e anëtareve/ëve në mbledhjet e KD është e detyrueshme;
2. Në rastet kur anëtarja/i i KD nuk mund të marrë pjesë në mbledhje, mungesa duhet të justifikohet me anë të një njoftimi paraprak me shkrim, në mënyrë elektronike dhe/ose në formë shkresore. Në këtë rast, drejtuesja/i e/i institucionit përkatës cakton një person zëvendësues për të marrë pjesë në atë mbledhje të KD.
3. Në rastet e mungesës së pajustificuar në dy mbledhje radhazi, Kryetarja/i i Bashkisë, njofton me shkrim vet drejtuesen/in e/i institucionit që nuk është paraqitur në mbledhjet e KD si dhe organin e emërtesës;
4. Çdo anëtar/e i KD është i detyruar të informojë me shkrim titullaren/in e institucionit përkatës, si dhe çdo strukturë tjetër përgjegjëse për vendimet ose masat e marra nga KD, me qëllim marrjen në kohë të masave që lidhen me veprimtarinë e asaj strukture;
5. Përfaqësueset/it e autoriteteve të tjera shtetërore në nivel vendor, të cilët janë anëtarë të ftuar rast pas rasti në KD, raportojnë në institucionet e tyre qendrore për veprimtarinë e KD, në lidhje me referimin dhe menaxhimin e rasteve të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje;
6. Në çdo raportim respektohet konfidencialiteti dhe mbrojtja e të dhënave personale të viktimave, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 12

Raportimi nga Komitetit Drejtues

1. KD raporton çdo gjashtë muaj për veprimtarinë e vet dhe për funksionimin e MKR pranë ministrisë përgjegjëse për çështjet e barazisë gjinore;
2. Pjesë e raportimit janë të dhënat e problemet e evidentuara për dhunën ndaj grave dhe dhunën në familje në territorin ku KD shtrin juridiksionin e vet, duke paraqitur, sipas rastit, propozime konkrete për mbështetjen që kërkohet nga autoriteti kryesor përgjegjës dhe/ose autoritetet e tjera të linjës;
3. KD, sipas problematikës së evidentuar, vë në dijeni, për sa më sipër, njërin prej ose të gjitha autoritetet përgjegjëse të linjës, sipas parashikimeve të ligjit në fuqi për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje;
4. Një kopje e raportit i vihet në dispozicion këshillit bashkiak dhe këshillit të qarkut;
5. Në çdo raportim, KD kujdeset që të ruhet fshehtësia e të dhënave personale të viktimave;
6. Në raste të nevojshme ose me kërkesë të autoriteteve përgjegjëse, KD paraqet edhe raporte të ndërmjetme.

KREU III

PËRBËRJA, DETYRAT DHE FUNKSIONIMI I EKIPIT TEKNIK NDËRDISIPLINOR (ETN)

Neni 13

Rregulla të përgjithshme

1. ETN ngrihet me vendim të KD me qëllim bashkërendimin e veprimtarisë së institucioneve të autoriteteve përgjegjëse, në nivel vendor për menaxhimin dhe riintegrimin e rasteve të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje.
2. ETN drejtohet nga KVe.
3. Përfaqësueset/it e institucioneve anëtare të ETN-së, kanë mandat dyvjeçar me të drejtë ripërtëritje. Ky mandat ndërpritet në rast transferimi në një detyrë tjetër, zëvendësimit nga institucioni, mospjesëmarrjes në mbledhje më shumë se dy herë pa arsye të justifikuara, ose për shkaqe të tjera sipas vlerësimit të institucionit.
4. Gjatë ushtrimit të detyrave të tyre, anëtarët/ët e ETN-së sigurojnë respektimin e konfidencialitetit, shmangien e viktimizimit dytësor dhe trajtimin me në qendër viktimën, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
5. ETN bashkëpunon me institucionet përgjegjëse për monitorimin e ngritjes dhe të funksionimit të shërbimeve të përkujdesit shoqërore për viktimat e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, që ofrohen pranë bashkive;
6. Anëtarët/ët e ETN-së kanë detyrimin të përcjellin në mënyrë periodike çdo muaj, të dhënat e përditësuara për fushën e tyre të përgjegjësisë në lidhje me menaxhimin e rasteve të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, pranë KV, për pasqyrim në sistemin REVALB, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale:
 - a. për këtë qëllim, çdo anëtar/e i/e ETN-së përcjell pranë KV-së, informacion për të gjitha rastet e paraqitura apo të trajtuara nga institucioni që përfaqëson, në përputhje me parimet e konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale.
7. ETN merr masa për përdorimin e rregullt dhe të detyrueshëm të sistemit REVALB dhe në bashkëpunim me KV monitoron zbatimin e detyrimeve të institucioneve sipas pikës 6 të këtij neni.

Neni 14

Përbërja e Ekipit Teknik Ndërdisciplinor

1. ETN-ja përbëhet nga përfaqësues/e teknikë të institucioneve që janë të përfaqësuara në KD, sipas nenit 7, pika 1 të këtij vendimi si edhe nga nivele teknike përfaqësimi, si: Zyra Vendore e Shërbimit të Provës, Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve, Nëpunësja/i i Barazisë Gjinore pranë bashkisë, profesionistë të lirë nga fushat sociale, të psikologjisë, shërbimit shëndetësor, mjekësisë ligjore, shoqërisë civile dhe institucionet e pavarura të të drejtave të njeriut në nivel vendor, si Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Avokati i Popullit.
2. Sipas rastit, në mbledhjet e ETN, mund të ftohen të marrin pjesë nivelet teknike të punonjëseve/ësve të institucioneve të njëjta me të ftuarit në mbledhjet e KD që nuk përfshihen në pikën 1, të këtij neni si dhe eksperte/ë me njohuri në çështjet e rendit të ditës.
3. Me qëllim adresimin e menjëhershëm të rasteve të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, krijohet dhe funksionon Njësia e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit (NVNR), si një strukturë bërthamë.

Neni 15

Mbledhjet e Ekipit Teknik Ndërdisciplinor

1. ETN-ja mbledhet në mbledhje të zakonshme çdo muaj dhe, sipas nevojës, në mbledhje të jashtëzakonshme, në veçanti për trajtimin e rasteve konkrete të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje që kërkojnë ndërhyrje të menjëhershme dhe të koordinuar;
2. ETN-ja, në bashkëpunim me grupin teknik ndërdisciplinor për mbrojtjen e fëmijëve (GTN), organizojnë mbledhje të përbashkëta, kur në rastet e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje janë të përfshirë edhe fëmijë, si viktimat të drejtpërdrejta, ose si dëshmitarë të dhunës;
3. Gjatë zhvillimit të mbledhjeve, ETN-ja siguron trajtimin e rasteve me në qendër viktimën, shmangien e viktimizimit dytësor dhe respektimin e parimit të interesit më të lartë të fëmijës, në zbatim të parimeve të legjislacionin në fuqi dhe nenit 5 të kësaj VKM-je.

Neni 16

Roli i punonjës/ punonjësit social në Ekipin Teknik Ndërdisciplinor

1. Punonjësja/ësi social pranë NJVNR-ve në bashki identifikon dhe referon rastet e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje pranë KV, përfshirë rastet e evidentuara, të raportuara ose të referuara nga institucionet dhe subjektet e tjera në territorin e bashkisë.
2. Punonjësja/ësi social referon pranë KV edhe rastet kur viktimat ka nevojë për shërbime mbështetëse, duke kryer vlerësimin fillestar të nevojave dhe duke orientuar rastin drejt shërbimeve përkatëse, në përputhje me standardet profesionale të punës sociale dhe legjislacionin në fuqi.
3. Gjatë ushtrimit të detyrave të saj/tij, punonjësja/si social siguron trajtimin me në qendër viktimën, respektimin e konfidentalitetit dhe shmangien e viktimizimit dytësor, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
4. Punonjësja/i social bashkëpunon me KV dhe me anëtarët/ët e ETN për ndjekjen dhe përditësimin e rasteve, në përputhje me detyrat dhe përgjegjësitë e tyre.

Neni 17

Detyrat e Ekipit Teknik Ndërdisciplinor

ETN-ja ka këto detyra:

1. Ndjek dhe menaxhon rastet, me kërkesën e personave të interesuar ose kryesisht, duke garantuar respektimin e të drejtave të viktimave dhe adresimin e nevojave të tyre, në përputhje me procedurat për menaxhimin e rastit.
2. Ndjek dhe siguron zbatimin e protokolleve, standardeve për vlerësimin e rrezikut, procedurave standarde të veprimit dhe planeve të ndërhyrjes;
3. Bashkërendon dhe garanton aksesin në shërbime për viktimat pavarësisht vendbanimit të tyre, përmes përdorimit të mekanizmave alternativë si shërbimet lëvizëse, ndërmjetësimin të shërbimeve dhe bashkëpunimit me organizatat e shoqërisë civile

- dhe të tjerë mbështetës rajonalë në përputhje me marrëveshjet dhe protokollet e miratuara përkatësisht dhe pa u kufizuar me: shërbimin e provës, strukturat e ndihmës juridike, shërbimet sociale dhe shëndetësore, strehëzat, qendrat e trajtimit të emergjencave dhe urdhrat profesionalë;
4. Bashkërendon punën me policinë e shtetit me qëllim:
 - a) marrjen dijëni në kohë reale nga strukturat përkatëse të Policisë së Shtetit, për situatën e dhunuesit varësisht faktit nëse është person në kërkim, është në arrati, ka përfunduar masën përkatëse të sigurimit personal ose dënimin penal; dhe
 - b) informimin e menjëhershëm të viktimës dhe ETN nga ana e Policisë së Shtetit me qëllim marrjen e të gjitha masave të nevojshme për të garantuar mbrojtjen, sigurinë e jetës dhe të shëndetit;
 - c) referimin dhe garantimin e aksesit të vazhdueshëm 24-orë në shërbimet e mbrojtjes dhe reagimit emergjent lidhur me referimin dhe menaxhimin e rasteve sipas këtij vendimi;
 5. Garanton koordinimin ndërmjet strukturave të Policisë së Shtetit me KV në rastet e dhunës të njoftuara ose ndodhura jashtë orarit zyrtar. Në këtë rast:
 - a) nga ana e bashkisë hartohet dhe zbatohet një grafik mujor gadishmërie për KV dhe/ose punonjësi/ja social/e i/e strukturës përgjegjëse për shërbimet sociale të ngarkuar; për trajtimin e rasteve të dhunës jashtë orarit zyrtar duke vlerësuar kapacitetet njerëzore dhe financiare të miratuara, procedurave të brendshme dhe legjisllacionit në fuqi për marrëdhëniet e punës.
 - b) KV dhe/ose punonjësi/ja social/e sipas germës b kontaktohet menjëherë pas marrjes së njoftimit dhe siguron ndjekjen fillestare të rastit brenda kohës më të shpejtë të mundshme, por jo më vonë se 2 orë nga marrja e njoftimit;
 - c) Ndjekja e rastit mund të realizohet fillimisht përmes komunikimit telefonik ose koordinimit institucional. Paraqitja fizike kryhet në përputhje me nivelin e emergjencës, vlerësimin e riskut dhe mundësitë objektive për ndërhyrje, duke garantuar kontaktin dhe koordinimin institucional në kohën më të shpejtë të mundshme.
 6. Koordinon ofrimin e ndihmës në rastet e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje në situata emergjencash civile dhe fatkeqësish natyrore, si dhe në rastet që përfshijnë shtetase dhe shtetas të huaj, si dhe persona pa shtetësi;
 7. Siguron që vlerësimi i rrezikut për çdo rast të realizohet në mënyrë të koordinuar ndërinstitutionale dhe të përditësohet në mënyrë periodike, duke garantuar që masat mbrojtëse dhe mbështetëse të jenë në përputhje me nivelin e rrezikut dhe nevojat e viktimës.
 8. Rastet e përsëritura të dhunës vlerësohen si raste me rrezik të lartë. Në këtë rast hartohet një plan ndërhyrjeje emergjente për trajtimin e rastit, përfshirë mbikqyrjen e shtuar.

Neni 18
Detyrat e ETN lidhur me raportimin

1. ETN raporton me shkrim, si rregull, dy herë në vit, në KD lidhur me bashkërendimin e veprimtarisë së institucioneve përgjegjëse në nivel vendor dhe për menaxhimin e rasteve të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje;
2. Sipas vlerësimit të ETN ose me kërkesë të KD mund të bëhet raportimi në KD përtej rregullit të parashikuar në pikën 1 të këtij neni;
3. Përfaqësueset/it e institucioneve në përbërje të ETN-së raportojnë në çdo mbledhje të ETN problematika të lidhura me menaxhimin e rasteve pranë institucioneve të tyre;
4. Përfaqësueset/it e institucioneve në përbërje të ETN-së raportojnë me shkrim dhe në kohë, pranë titullareve/ëve të këtyre institucioneve lidhur me veprimtarinë dhe mbledhjet e ETN-së dhe, sipas rasti, paraqesin problematikat e rasteve të referuara dhe sugjerojnë përmirësime ose masa konkrete për mënyrën e menaxhimit të tyre.

KREU IV KOORDINATORI VENDOR (KV)

Neni 19 Rregulla të përgjithshme

1. Pranë çdo bashkie caktohet KV.
2. KV kryen veprimtari të dedikuara posaçërisht për kryerjen e këtij funksioni koordinues.
3. Këshilli bashkiak, me propozimin e kryetares/it të bashkisë, përcakton numrin e KV-ve dhe përbërjen e njësisë kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje. Për këtë vendimmarrje, Këshilli bashkiak vlerëson në mënyrë kumulative numrin, shumëllojshmërinë dhe vështirësitë e rasteve të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje dhe numrin e popullsisë sipas pikës 4 të këtij neni për atë bashki.
4. Nisur vetëm nga numri i popullsisë, këshilli bashkiak mban në vëmendje kriteret minimum si më poshtë vijon:
 - a) në bashkitë me mbi 100 000 (njëqind mijë) banorë/ë krijohet një njësi kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje e përbërë nga jo më pak se 4 (katër) KV me kohë të plotë, që bashkëpunojnë me nga një administrator/e shoqëror ose punonjës/e social, për çdo njësi administrative;
 - b) në bashkitë me 80 000 (tetëdhejtë mijë) deri në 100 000 (njëqind mijë) banorë/ë krijohet një njësi kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje e përbërë nga jo më pak se 2 (dy) KV me kohë të plotë, që bashkëpunojnë me nga një administrator/e shoqëror ose punonjës/e social, për çdo njësi administrative;
 - c) në bashkitë me më pak se 80 000 (tetëdhejtë mijë) banorë/ë krijohet një njësi kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje e përbërë nga një KV me kohë të plotë, që bashkëpunon me nga një administrator/e shoqëror, ose punonjës/e asocial, për çdo njësi administrative.
5. KV ushtron funksionet e veta pa mbivendosje me detyra të tjera, në mënyrë që të garantohet përmbushja efektive e rolit koordinues. Në rastet kur ka vetëm një KV dhe

për arsye objektive nuk gjendet ne zyrë, delegimi i kompetencës bëhet nga kryetarja/i i bashkisë.

6. KV është anëtar/e i/e grupit të punës që përgatit planet sociale, ku analizohen nevojat sociale dhe parashikohen masat për përmirësimin ose ngritjen e shërbimeve të reja për personat e përfshirë në dhunën ndaj grave dhe dhunën në familje, si dhe anëtar/e i/e grupit të punës që përgatit planet vendore të veprimit për barazinë gjinore.
7. Për ushtrimin efektiv të detyrave merren masa që KV të ketë akses në sistemet e informacionit, në hapësira të mjaftueshme dhe të dedikuara pune, burime njerëzore mbështetëse dhe mjete logjistike.

Neni 20

Mbështetja e Koordinatorës/it Vendor

1. Në përmbushjen e detyrave dhe të përgjegjësisve KV lehtësohet nga anëtarët/ët e MKR-së, nga një ekip mbështetës, ose nga njësisia e vlerësimit të nevojave dhe referimit (NJVNR), në rastet kur kjo është ngritur pranë bashkisë, për ndjekjen e rastit në terren.
2. Anëtarët/ët e MKR-së në bazë të legjislacionit në fuqi për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje, si dhe në zbatim të këtij vendimi, asistojnë dhe mbështesin KV për monitorimin dhe/ose kryerjen e detyrave të tjera.
3. Ekipi mbështetës dhe NJVNR caktohet, sipas rastit, me urdhër të kryetares/it të bashkisë dhe ka për qëllim të lehtësojë KV-në në përballimin e ngarkesës, veçanërisht në bashkitë me numër të madh banoresh/ësh dhe numër, shumëllojshmëri dhe vështirësi të rasteve të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje
4. Pjesë e ekipit mbështetës të KV janë përfaqësues/e nga shërbimet brenda bashkisë.

Neni 21

Akresi i KV në informacion

1. KV-ja ka akses në informacion lidhur me shërbimet e ofruara për rastet e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje në çdo bashki, me qëllim ndjekjen e rastit e të historikut të tij, nga të gjithë institucionet përgjegjëse.
2. Për këtë qëllim KV-ja merr informacion, por pa u kufizuar nga:
 - a) raportet mujore të shërbimeve sociale të njësive përkatëse të vetëqeverisjes vendore dhe/ose organizatat që ofrojnë shërbime, që, sipas rastit, të mbështesin me ndihmë psikosociale, shëndetësore e financiare personat e dhunuar, si dhe për monitorimin e respektimit të urdhrave të mbrojtjes (në vijim, UM) nga palët;
 - b) përgjegjëset/it e programit të rehabilitimit të dhunuesve;
 - c) përgjegjëset/it e programit të rehabilitimit dhe riintegritimit të viktimave të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje;
 - d) institucionet e ndjekjes dhe ekzekutimit të vendimit penal në lidhje me masën e sigurisë dhe ndryshimeve të saj, si dhe në lidhje me përfundimin e vuajtjes së plotë të dënimit penal të formës së prerë;
 - e) shërbimi i provës lidhur me zbatimin e masave të përcaktuara nga gjykata;

- f) institucionet dhe/ose profesionistet/ët anëtarë/e të ETN-së .

Neni 22

Detyrat koordinuese dhe drejtuese të Koordinatorës/it Vendor

Me qëllim koordinimin dhe drejtimin efektiv të veprimtarisë KV:

- a) Drejton, organizon mbledhjet e ETN-së dhe i dokumenton ato duke mbajtur të dhëna në lidhje me takimet e ETN-së, pjesëmarrjen, diskutimet dhe ndjekjen e tyre;
- b) Informon KD për ecurinë e punës, për bashkërendimin e veprimtarisë së institucioneve në nivel vendor dhe për referimin, menaxhimin dhe riintegrimin e rasteve të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje;
- c) Koordinon veprimtarinë e ETN-së për rastet që kërkojnë ndërhyrje të menjëhershme, duke siguruar referimin dhe aksesin në shërbime të nevojshme, përfshirë strehimin, ndihmën juridike falas, këshillim dhe shërbime të tjera mbështetëse;
- d) Merr pjesë me ftesë në mbledhjet e GTN si dhe në mbledhjet e përbashkëta të ETN-së me GTN-në, në rastet kur dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje përfshin edhe fëmijë, si viktimë ose dëshmitarë të dhunës;
- e) Koordinon veprimtarinë dhe bashkëpunon me punonjësen/in social pranë strukturave të shërbimeve sociale në bashki, si dhe me administratoret/ët shoqërorë dhe punonjëset/it socialë në njësitë administrative:
 - a) Koordinon veprimtarinë me administratoret/ët shoqërorë dhe punonjëset/it/ socialë të njëjësive administrative, duke siguruar mbulimin me shërbime edhe në zonat rurale dhe periferike;
 - b) Koordinon bashkëpunimin me shërbimet sociale dhe qendrat e trajtimit për viktimat, duke përfshirë strehëzat, qendrat e emergjencës dhe shërbimet e specializuara, si dhe me programet për trajtimin dhe rehabilitimin e dhunuesve;
 - c) Siguron mekanizma efektivë dhe të shpejtë komunikimi, përfshirë mekanizma joformalë, ndërmjet aktorëve të përfshirë në menaxhimin e rasteve, me qëllim reagimin në kohë dhe koordinimin e ndërhyrjeve për mbështetjen e viktimave;
 - d) Siguron koordinimin ndërinstitutional për vlerësimin e rrezikut dhe menaxhimin e rasteve, duke garantuar që çdo rast i dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje të trajtohet mbi bazën e një vlerësimi të individualizuar të rrezikut dhe që institucionet përgjegjëse të ndërmarrin në kohë masat e nevojshme mbrojtëse dhe mbështetëse, në përputhje me procedurat e miratuara.
- e) Kërkon në mënyrë zyrtare informacion dhe veprim nga institucionet anëtare të MKR për rastet në trajtim dhe ndjek përmbylljen e detyrimeve të tyre, në përputhje me këtë vendim dhe legjislacionin në fuqi.
- f) Siguron funksionimin e një mekanizmi të menjëhershëm njoftimi ndërinstitutional për rastet me rrezik të lartë, duke garantuar informimin pa vonesë të anëtareve/ëve të ETN-së dhe aktivizimin e menjëhershëm të ndërhyrjes së koordinuar.
- g) Identifikon nevojat për përmirësim të protokolleve ekzistuese ose marrëdhënie informale bashkëpunimi me struktura të tjera pranë bashkisë/njëjësive administrative;

- h) harton një listë të organizatave jofitimprurëse, si dhe të profesionisteve/ëve, që ofrojnë shërbime falas për viktimat e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje (psikologjike, këshillim, shërbime mjekësore, juridike falas, strehim, etj), e përditëson atë rregullisht dhe e vendos në dispozicion të ETN;
- i) ndërmjetëson me OJF-të, Policinë e Shtetit, shërbimet shëndetësore, gjykatat, Shërbimin e Provës, strukturat e shërbimit të ndihmës juridike, shërbimet sociale dhe institucione/organizata të tjera referimi e trajtimi të rasteve, për të marrë e dhënë informacion, për t'i lidhur viktimat me shërbimet, si dhe për të siguruar vazhdimësinë e kujdesit ndaj tyre.

Neni 23

Detyrat e Koordinatorës/it Vendor lidhur me urdhërat e mbrojtjes

Në lidhje me urdhërat e mbrojtjes KV ka këto detyra:

1. Asiston viktimat me njohjen e të drejtave dhe në ndjekjen e procedurave të nevojshme për marrjen e urdhrave të mbrojtjes, si dhe i informon për masat e mbrojtjes dhe hapat që duhen ndjekur në rast shkeljeje të tyre, përfshirë:
 - a) urdhërat e mbrojtjes ndaj dhunës në familje [Urdhër për Masa Paraprake të Mbrojtjes së Menjëhershme (UMPMM), Urdhër i Menjëhershëm Mbrojtjeje (UMM) apo Urdhër Mbrojtjeje (UM)] ;
 - b) urdhërat e mbrojtjes për dhunën e lehtësuar nga teknologjia [Urdhër për Masa Paraprake të Mbrojtjes së Menjëhershme (UMPMM), Urdhër i Menjëhershëm Mbrojtjeje (UMM) apo Urdhër Mbrojtjeje (UM)] ;
 - c) urdhërat e mbrojtjes ndaj grave në proceset zgjedhore dhe në politikë [Urdhër për Masa Paraprake të Mbrojtjes së Menjëhershme (UMPMM), Urdhër i Menjëhershëm Mbrojtjeje (UMM) apo Urdhër Mbrojtjeje (UM)] ;
 - d) urdhërat e mbrojtjes për dhunën dhe ngacmimin seksual në punë [Urdhër i Menjëhershëm Mbrojtjeje (UMM) apo Urdhër Mbrojtjeje (UM)] ;
2. Bën referimin e viktimave pranë ofruesve të ndihmës juridike të përcaktuar sipas kuadrit ligjor në fuqi për ndihmën juridike të garantuar nga shteti.
3. Njofton policinë dhe, sipas rrezikut të rastit, bashkërisht ose vet shoqëron viktimën që raporton dhunën pranë gjykatës, policisë dhe shërbimeve të tjera. Nëse ndodh që, në fazën e parë të raportimit, subjektet e raportimit pretendojnë njëkohësisht se janë dhunues dhe viktimë, KV bën referimin e raportuesit të dytë, pranë ndihmës juridike falas;
4. Mbështet viktimat në paraqitjen e kërkesës pranë gjykatës për lëshimin e UMM/UM duke siguruar që dosjet dhe dokumentacioni rreth viktimave të jetë i saktë, i plotë dhe i përditësuar, si dhe siguron ruajtjen e kopjeve të urdhrave të gjykatës dhe të dokumentacionit të kërkuar. Merr një kopje të urdhrit për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme dhe ndjek zbatimin e tij;
5. Në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje, paraqet dhe/ose mbështet paraqitjen e kërkesës pranë gjykatës për ndryshimin, shtimin e masave ose ndërprerjen e masave

- të urdhrat të mbrojtjes, kur rrethanat e rastit kanë ndryshuar ose kur masat ekzistuese vlerësohen të pamjaftueshme për garantimin e mbrojtjes së viktimës.
6. Monitoron, gjatë gjithë kohëzgjatjes së urdhrave të mbrojtjes, zbatimin e tyre nga palët dhe, çdo 60 (gjashtëdhjetë) ditë, përgatit raporte përkatëse, duke vënë në dijeni Policinë e Shtetit për çdo rast shkeljeje;
 7. Në rastet e dhunës në familje, bashkëpunon sipas rastit me policinë dhe institucionet përkatëse për zbatimin e vendimeve gjyqësore lidhur me urdhrat e mbrojtjes, përfshirë masat që lidhen me kontaktin dhe vizitat;
 8. Bashkëpunon me policinë për zbatimin e masave për largimin e dhunuesit nga banesa dhe garantimin e sigurisë së viktimës dhe fëmijëve, në përputhje me vendimet gjyqësore;
 9. Në rastet e shkeljes së UMPMM, UMM, UM, siguron, në bashkëpunim me policinë e shtetit, rishikimin e vlerësimit individual të rrezikut dhe koordinon marrjen e masave shtesë mbrojtëse, për shkak të shtimit të rrezikut për viktimën dhe/ose sipas nevojës.
 10. Bashkëpunon dhe informon policinë me qëllim rivlerësimit të rrezikut në rastet e shkeljes së UMPMM, UMM, UM dhe për një reagim të menjëhershëm edhe nga ana institucioneve të tjera përgjegjëse.
 11. Bashkëpunon me shërbimin e provës për monitorimin e ekzekutimit të UMM, UM, sipas rregullave të parashikuara në legjisllacionin në fuqi për mbikëqyrjen elektronike të personave që u kufizohet lëvizja me vendim gjyqësor;
 12. Jep ndihmë dhe mbështetje, në rast nevojë të argumentuar, kërkesës së shërbimit përmbartimor për ekzekutimin e UM/UMM duke u mbështetur sipas rastit nga strukturat e Policisë së Shtetit, ose zyra e shërbimeve sociale të njësisë vendore, ku janë me banim të përhershëm ose të përkohshëm viktimat dhe personat e tjerë të përmendur në vendim, punëdhënësi, si dhe çdo institucion tjetër i ngarkuar për zbatimin e vendimit gjyqësor;
 13. Kërkon dhe siguron përgjigje në kohë nga institucionet anëtare të MKR për rastet në trajtim dhe, në rast mosreagimi, informon KD për marrjen e masave përkatëse;
 14. Harton planin e përbashkët të ndërhyrjes (PPN) në bashkëpunim me ETN sipas parashikimeve në këtë vendim.

Neni 24

Detyrat e Kordinatores/it Vendor në lidhje me KD

1. Detyrat e KV në lidhje me Komitetin Drejtues përfshijnë:
 - a) hartimin dhe paraqitjen e dokumenteve të nevojshme për shqyrtim nga KD të paktën 15 ditë përpara mbledhjes.
 - b) hartimin e projekt-marrëveshjeve të bashkëpunimit ndërmjet institucioneve përgjegjëse për zbatimin e legjisllacionit në fuqi për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje, në përputhje me modelin e miratuar të marrëveshjes së bashkëpunimit, dhe ia propozon KD për miratim;
 - c) paraqitjen e raporteve gjashtëmujore dhe vjetore përpara KD, për bashkërendimin e veprimtarisë së institucioneve në nivel vendor dhe referimin e rasteve të dhunës,

në formë të përmbledhur, duke u kujdesur që të ruhet fshehtësia e të dhënave personale të viktimave. Këto raporte përmbajnë informacion për rastet në të cilat është ndërhyrë, për procedurat e ndjekura, masat e ndërmarra dhe problemet e ndeshura, që mund të kërkojnë zgjidhje nga KD;

- d) identifikimin dhe paraqitjen e nevojave për krijimin, zgjerimin ose përmirësimin e shërbimeve të nevojshme për viktimat e dhunës në strukturën e shërbimeve sociale pranë bashkisë.
- e) dokumenton të dhënat në lidhje me takimet e KD, pjesëmarrjen, diskutimet dhe ndjekjen e tyre.

Neni 25

Detyra ndërgjegjësuere dhe trajnuere të Koordinatorës/it Vendor

Detyrat e KV lidhur me ndërgjegjësimin dhe trajnimin përfshijnë:

- a) koordinimin dhe organizimin e trajnimeve të ndërmarra nga strukturat përgjegjëse dhe OJF-të e licensuara, sipas legjislacionit në fuqi për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje, për ETN dhe personelin tjetër që punon me komunitetin;
- b) mbështetjen e informimit të anëtareve/ëve të komunitetit, profesionisteve/ëve, si dhe OJF-ve rreth dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, si dhe shërbimin me materiale ose botime të ndryshme sensibilizuese e ndërgjegjësuere për dhunën, sipas kësaj VKM;

Neni 26

Detyra të KV lidhur me mbledhjen e të dhënave dhe statistikave

1. Administrimi, përpunimi dhe raportimi i të dhënave për rastet realizohet në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale dhe përmes sistemeve përkatëse elektronike.
2. KV ka këto detyra lidhur me mbledhjen e të dhënave dhe statistikave:
 - a) pasqyron të dhënat dhe statistikën në raportet e ETN;
 - b) koordinon mbledhjen e të dhënave dhe statistikave me anëtarët/ët e ETN-së;
 - c) mbledh dhe përditëson hedhjen e të dhënave për të gjitha rastet e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje në sistemin REVALB përfshirë të dhëna nga OJF-të e licensuara.
3. KV-ja bazuar në të dhënat e sistemit REVALB:
 - a) ndan në fillim të çdo muaji raportet e përditësuara që gjeneron ky sistem si dhe një informacion të përmbledhur për rastet e trajtuara nga ETN gjatë muajit të mëparshëm dhe ia paraqet ETN në mbledhjen e radhës. Sipas rastit, këto raporte mund të jenë të koduara, që sigurojnë fshehtësinë e emrit të viktimës;
 - b) paraqet raporte tremujore, gjashtëmujore dhe vjetore përpara KD dhe autoritetit kryesor përgjegjës me informacion të përmbledhur për rastet e trajtuara, bashkërendimin e veprimtarisë së institucioneve në nivel vendor dhe referimin e

rasteve të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, duke u kujdesur që të ruhet fshehtësia e të dhënave personale të viktimave.

4. Raporte sipas pikës 3 të këtij neni përmbajnë informacion për rastet në të cilat është ndërhyrë, për procedurat e ndjekura, masat e ndërmarra dhe problemet që janë ndeshur gjatë menaxhimit të rastit duke paraqitur nevojat për zgjidhje nga KDs ose autoriteti kryesor përgjegjës.

KREU V

RREGULLA TË PËRGJITHSHME PËR MENAXHIMIN E RASTIT TË DHUNËS NDAJ GRAVE DHE DHUNËS NË FAMILJE

Neni 27

Parimet dhe llojet e procedurave

1. Rregullat dhe hapat proceduralë të ndjekur nga MKR në trajtimin dhe menaxhimin e rasteve të raportuara të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje bazohen mbi të njëjtat parime dhe kanë si qëllim parandalimin dhe mbrojtjen e viktimave të formave të ndryshme të dhunës sipas legjislacionit në fuqi
2. Anëtarët e MKR në menaxhimin e rastit të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje vlerësojnë veçoritë e formave të ndryshme të dhunës duke bërë përshtatjen e arsyeshme të rolit të tyre rast pas rasti.
3. Menaxhimi i rasteve të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje bazohet në qasjen me në qendër viktimën, duke garantuar:
 - a) respektimin e dinjitetit, sigurisë dhe të nevojave të viktimës;
 - b) shmangien e viktimizimit dytësor dhe riviktimizimit, përfshirë edhe shmangien e intervistimit të përsëritur të viktimës dhe realizimin e intervistës të koordinuar dhe mundësisht vetëm një herë;
 - c) vlerësimin individual me qëllim eliminimin e çdo rreziku për viktimën dhe ndërmarrjen e masave përkatëse mbrojtëse në kohë.
 - d) garantimin e pjesëmarrjes së informuar të viktimës në proceset vendimmarrëse lidhur me të.
4. Procedurat e lidhura me rastet e dhunës ndaj grave dhe rregullonë dhe përfshijnë familje menaxhimin dhe trajtimin e rasteve të:
 - a) dhunës në familje
 - b) dhunës, ngacmimit dhe ngacmimit seksual në punë;
 - c) dhunës ndaj grave në proceset zgjedhore dhe në jetën politike;
 - d) dhunës së lehtësuar nga teknologjia.
5. Në çdo rast KV, policia e shtetit dhe institucionet përgjegjëse sigurojnë orientimin dhe mbështetjen e viktimës për akses në mekanizmat e raportimit, të mbrojtjes dhe shërbimeve përkatëse.
6. Procedurat e detajuara për menaxhimin e rasteve të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, përfshirë rolet, përgjegjësitë dhe hapat e ndërveprimit të autoriteteve përgjegjëse, përcaktohen në Procedurat Standarde të Veprimit, protokollet dhe standardet përkatëse që miratohen në zbatim të këtij vendimi.

Neni 28

Raportimi i dhunës

1. Në çdo rast të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje zbatohen rregullat e legjilacionit përkatës në fuqi për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje lidhur me raportimin dhe moskufizimet e raportimit lidhur me profesionin.
2. Viktima e dhunës dhe/ose çdo person fizik a juridik, publik ose privat, që konstaton një rast të ushtrimit të dhunës, raporton rastin pranë KV-së, Policisë së Shtetit ose çdo institucioni anëtar të ETN-së.
3. Pavarësisht se në cilin prej institucioneve të ETN-së raportohet rasti i dhunës, është detyrë e tyre që nëse konstatojnë se ka nevojë për ndërhyrje, të njoftojnë menjëherë KV-në dhe Policinë e shtetit me qëllim marrjen e masave të nevojshme për vlerësimin e nevojave dhe trajtimin e rastit.
4. Viktima ka të drejtë të raportojë edhe njëkohësisht ose jo pranë çdo autoriteti pjesë e MKR ose gjykatës së shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm të vendbanimit ose vendndodhjes së viktimës ose dhunuesit për të kërkuar marrjen e masave të nevojshme për mbrojtje e siguri.
5. Në rastin e dhunës, ngacmimit ose ngacmimit seksual në punë, viktima ka të drejtë të raportojë rastin, njëkohësisht ose jo, përveç mekanizmave sipas pikës 4 të këtij neni edhe pranë mekanizmave të brendshëm të vendit të punës.
6. Raportimi i rasteve të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje mund të realizohet edhe përmes teknologjisë së informacionit dhe komunikimeve elektronike, nëpërmjet kanaleve të aksesueshme dhe të sigurta, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
7. Autoritetet përgjegjëse marrin masa për zhvillimin dhe përdorimin e mekanizmave të sigurt elektronikë për raportimin sipas pikës 6 të këtij neni dhe ndjekjen e rasteve. si dhe sigurojnë mbrojtjen e identitetit dhe të të dhënave personale të viktimës dhe të raportuesit/es së dhunës, përfshirë ruajtjen e anonimatit, kur kjo është e nevojshme dhe në interesin më të lartë të viktimës dhe të raportuesit.

Neni 29

Rregulla bazë të menaxhimit të rastit

1. Çdo autoritet që vihet në dijeni drejtpërdrejtë ose përmes raportimit sipas nenit 28 të këtij vendimi, merr menjëherë masa me qëllim:
 - a) mbrojtjen dhe sigurinë e viktimës;
 - b) vlerësimin paraprak të rrezikut;
 - c) njoftimin e KV dhe Policisë së Shtetit;
 - d) referimin e rastit për shërbime mbështetëse, sipas nevojës.
2. KV dhe policia e shtetit kanë rol me rëndësi në menaxhimin dhe monitorimin e rastit dhe në bashkëpunim me institucionet e tjera përgjegjëse pjesë e ETN në zbatim të legjilacionit për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhunë ndaj grave dhe dhuna në familje, nga ky vendim si dhe nga standardet e përcaktuara në protokollet dhe procedurat në bazë në zbatim të kësaj VKM-je.

3. KV që merr dijëni për dhunën drejtpërdrejtë ose përmes raportimit, merr masa duke përfshirë por pa u kufizuar në:
 - a) identifikimin dhe vlerësimin e nevojave të viktimës dhe vlerësimin individual të rrezikut;
 - b) koordinimin ndërinstucional për menaxhimin e rastit;
 - c) ndërmarrjen e masave të menjëhershme mbrojtëse, sipas rastit;
 - d) marrjen e masave mbrojtëse të menjëhershme në rastet emergjente, hartimin e planit të përbashkët të ndërhyrjes dhe koordinimin afatgjatë të tyre;
 - e) hartimin në çdo rast dhe me mbështetjen e ETN të një plani të përbashkët ndërhyrjeje (PPN), i cili përcakton masat, shërbimet dhe përgjegjësitë për trajtimin, rehabilitimin dhe riintegrimin e viktimës për zbatimin e masave mbrojtëse të menjëhershme dhe afatgjata, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe ja paraqet për miratim, së bashku me analizën e riskut drejtorit të strukturës përkatëse për shërbimet shoqërore në bashki.
4. KV përgatit dosjen dhe u dërgon anëtarëve përkatës të ETN-së raportin e referimit të rastit me të dhënat shoqërore për viktimën e dhunës në familje, analizën e riskut, urdhrin e mbrojtjes që është lëshuar, si dhe dokumente të tjera bashkëshoqërore, duke caktuar detyrat për secilin prej tyre, afatet përkatëse, si dhe shërbimet që kanë nevojë të mbulohen me shpenzime.
5. Drejtori i strukturës përkatëse për shërbimet shoqërore në bashki, vlerëson, brenda të njëjtës ditë PPN sipas pikes 3 germa 'e' të këtij neni, shpenzimet që nevojiten, miratimin e PPN-së si dhe në vijim dhe bën prokurimin e shërbimeve që kërkojnë shpenzime që nuk përmbushen nga shporta e shërbimeve. Në pamundësi financiare, drejtori orienton kryerjen e shërbimeve në mënyrë progresive në varësi të shtimit të fondeve ose kërkon bashkëpunimin e anëtarëve të tjerë të ETN-së për përmbushjen e shërbimeve.
6. KV-ja u dërgon zyrtarisht të gjithë anëtarëve të ETN-së që do të mbështesin rastin, PPN-në përfundimtare ditë e nesërme.
7. Policia e Shtetit në bashkëpunim me KV-në kryen, por pa u kufizuar:
 - a) vlerësimin dhe menaxhimin e rrezikut,
 - b) lëshon, sipas rastit, Urdhrin për Masat Paraprake të Mbrojtjes së Menjëhershme (UMPM) dhe merr masat për zbatimin e tij,
 - c) në bashkëpunim me KV-në, dhe, nëse është rasti, me përfaqësuesin e zyrës së përmbartimit, marrin masa për largimin e dhunuesit nga banesa si dhe në procedura të tjera përmbartimore;
8. Viktimat në moshë të mitur trajtohen në bashkëpunim me Njësinë për Mbrojtjen e Fëmijëve pranë njësisë vendore përkatëse.
9. Nëse nga vlerësimi i riskut rezulton rasti i viktimës së dhunuar seksualisht, KV-ja, së bashku me strukturën përgjegjëse të Policisë së Shtetit, dërgojnë menjëherë viktimën në një qendër të menaxhimit të krizës për rastet e dhunës seksuale.
10. Në rastet kur në të gjithë vendin ose në njësinë e vetëqeverisjes vendore janë shpallur masat e jashtëzakonshme, do të ndiqen procedurat e posaçme të menaxhimit të rasteve të miratuara nga autoriteti kryesor përgjegjës për zbatimin e ligjit për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare.

11. Procedurat e detajuara për menaxhimin e rasteve sipas formës së dhunës, përfshirë vlerësimin e rrezikut, hartimin dhe zbatimin e planit të ndërhyrjes, si dhe koordinimin ndërinstytucional, përcaktohen në procedurat standarde të veprimit, protokollet dhe standardet përkatëse, që do përgatiten dhe miratohen në vijim të kësaj VKM.

Neni 30

Administrimi dhe raportimi i të dhënave

1. KV-ja, punonjësi i Policisë së Shtetit dhe të gjithë personat e institucionet që përfshihen në menaxhimin e rastit të dhunës kanë detyrimin të ruajnë fshehtësinë e të dhënave personale për viktimat e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, fëmijëve dhe anëtarëve të tjerë të familjes, si dhe të dhënave për dhunuesin.
2. çdo anëtar i ETN, një herë në muaj, nëpërmjet formularit të mbledhjes së të dhënave, përcjell tek KV-ja informacionin për të gjitha rastet e paraqitura apo të trajtuara nga institucioni i tij/saj, pavarësisht nëse ndërhyrja ka qenë e përbashkët, ndërdisiplinore apo është trajtuar vetëm brenda institucionit;
3. KV-ja, në bashkëpunim me të gjithë anëtarët e ETN-së që kanë menaxhuar rastin, dokumenton:
 - a) të dhënat për informacionin e marrë, llojin e dhunës, veprimet e kryera, shërbimet e ofruara dhe rezultatet e arritura gjatë procesit të menaxhimit të rastit të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje;
 - b) të dhënat për dhunuesin;
 - c) të dhënat për fëmijët që kanë pësuar dhunë, si dhe për viktimat e dhunës seksuale;
 - d) të dhënat për të gjitha llojet e mbrojtjes dhe trajtimit deri në rehabilitimin e viktimës si dhe gjurmimin e monitorimit të ekzekutimit të tyre;
4. Të dhënat sipas pikës 3 të këtij neni regjistrohen dhe përditësohen nga KV-ja, përpunohen dhe administrohen prej tij në sistemin elektronik të ruajtjes së të dhënave pranë bashkisë ëë.revalb.org, në një seksion të veçantë të sistemit elektronik REVALB në përputhje me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale dhe aktet nënligjore përkatëse.
5. Sistemi REVALB përfshin hedhjen e përditësimin e të dhënave statistikore të rasteve të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, veprimet e kryera, shërbimet e ofruara, si dhe të elementeve, që kanë lidhje me monitorimin e funksionimit të MKR.
6. Sistemi REVALV synon:
 - a) mbledhjen e të dhënave dhe sistemimin e tyre, si dhe ndjekjen e tyre në kohë reale;
 - b) koordinimin e përpjekjeve ndërinstytucionale, në mënyrë që të mundësohet ofrimi i zgjidhjeve të menjëhershme për rastet e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje;
 - c) unifikimin dhe kompjuterizimin e mbledhjes së të dhënave, me qëllim krijimin e një baze statistikore që ndihmon analizën dhe orientimin e përmirësimit të politikave në lidhje me dhunën ndaj grave dhe dhunën në familje.
7. Drejtoria e shërbimeve sociale dhe KV-ja, me qëllim harmonizimin e të dhënave, bashkëpunojnë me organet e tjera që gjenerojnë të dhëna sipas legjislacionit në fuqi, duke nënshkruar marrëveshje për bashkëpunimin ndërmjet tyre;

Neni 31

Veçoritë e menxhimit në rastet me shtetas/e të huaj dhe persona pa shtetësi

1. Në rastin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në famije së raportuar nga të huajat/të dhe personat pa shtetësi, autoritetet përgjegjëse njoftojnë strukturat e migracionit dhe azilit për të garantuar mbrojtjen e viktimës, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
2. Në rastet sipas pikës 1 të këtij neni autoritetet marrin masa për pezullimin e menjëhershëm të çdo procedure largimi, duke garantuar mbrojtjen e viktimës deri në përfundimin e shqyrtimit të kërkesës për azil, si dhe për lejen e qëndrimit ose të rinovimit të saj, sipas legjislacionit në fuqi për të huajt dhe azilin.
3. Në çdo rast, trajtimi i viktimave nuk kushtëzohet nga statusi i tyre i qëndrimit.

Neni 32

Masat lidhur me manaxhimi të rasteve të dhunës përmes teknologjisë së informacionit

1. Raportimi i rasteve të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje mund të realizohet edhe përmes teknologjisë së informacionit dhe komunikimeve elektronike, nëpërmjet kanaleve të aksesueshme dhe të sigurta, në përputhje me legjislacionin në fuqi
2. Në këto raste, autoritetet përgjegjëse sigurojnë mbrojtjen e identitetit dhe të dhënave personale të viktimës, përfshirë ruajtjen e anonimatit, kur kjo është e nevojshme dhe në interesin më të lartë të viktimës.
3. Vëmendje e veçantë i kushtohet garantimit të sigurisë dhe aksesueshmërisë së raportimit për grupet në nevojë, përfshirë fëmijët, gratë dhe vajzat, të moshuarat/it apo moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuara.
5. Autoritetet përgjegjëse marrin masa për zhvillimin dhe përdorimin e mekanizmave të sigurt elektronikë për raportimin dhe ndjekjen e rasteve.
6. Trajtimi i rasteve të dhunës së lehtësuar nga teknologjia realizohet në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet nënligjore përkatëse për zbatimin e tij.

Neni 33

Masat lidhur me dhuna ndaj grave në proceset zgjedhore dhe në politikë

1. Në rastet e dhunës ndaj grave në proceset zgjedhore dhe në jetën politike, viktimat ka të drejtë të raportojë rastin pranë institucioneve përgjegjëse dhe të përfitojë mbrojtje, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
2. Në rastet e dhunës ndaj grave në proceset zgjedhore dhe në jetën politike, KV, në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse, siguron orientimin dhe mbështetjen e viktimës për akses në mekanizmat përkatës të mbrojtjes dhe raportimit, përfshirë procedurat për marrjen e urdhrave të mbrojtjes, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
3. KV bashkërendon veprimet me institucionet përgjegjëse për adresimin e rasteve dhe për garantimin e mbrojtjes efektive të viktimës.
4. Në këto raste, sigurohet që trajtimi i viktimës të kontribuojë në mbrojtjen e të drejtës së grave për pjesëmarrje të lirë dhe të sigurt në jetën publike dhe politike.

5. KV, sipas rastit, orienton viktimën për raportimin e dhunës pranë institucioneve përgjegjëse për proceset zgjedhore dhe organeve të tjera kompetente, në përputhje me legjislacionin zgjedhor dhe atë për parandalimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje në fuqi.

Neni 34

Masat lidhur me dhunën ndaj grave, ngacmimi, ngacmimi seksual

1. Në rastet e dhunës, ngacmimit dhe ngacmimit seksual në punë, viktimja ka të drejtë të raportojë rastin, njëkohësisht ose jo, pranë:
 - a) mekanizmeve të brendshëm të subjektit publik ose privat;
 - b) mekanizmeve administrativë të jashtëm;
 - c) gjykatës kompetente në përputhje me legjislacionin në fuqi.
2. KV sapo vendoset në dijeni të dhunës ndaj grave, ngacmimit dhe ngacmimit seksual, në koordinim me institucionet përgjegjëse informon dhe orienton viktimën:
 - a) për mundësinë e raportimit të dhunës pranë mekanizmeve të brendshëm, joformalë dhe formalë të subjektit publik ose privat, të përcaktuar për mbrojtjen ndaj dhunës, ngacmimit dhe ngacmimit seksual; mekanizmeve të jashtëm, dhe sipas rastit, inspektoratit përgjegjës për zbatimin e legjislacionit të punës, Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe/ose mekanizmeve të të drejtave të njeriut;
 - b) për të përfituar shërbim ligjor falas për të vënë në lëvizje me kërkesëpadi gjykatën e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm të vendbanimit ose vendndodhjes së saj ose të dhunuesit për të kërkuar marrjen e masave të nevojshme për mbrojtje e siguri të viktimës;
 - c) lidhur me të gjitha shërbimet mbështetëse të përgjithshme dhe të specializuara në dispozicion;
 - d) për mbledhjen dhe ruajtjen e provave që lidhen me dhunën, ngacmimin dhe ngacmimin seksual.

IV. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Për zbatimin e këtij vendimi, ministrja ose ministri përgjegjës për çështjet e barazisë gjinore dhe çështjet sociale me udhëzim harton dhe miraton procedurat standarde të detajuara të veprimit për menaxhimin e rasteve të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje sipas llojeve të dhunës dhe standartet e ofrimit të shërbimeve, formatin bazë të raportimit në kuadër të MKR, si dhe siguron publikimin e tyre në faqen zyrtare të internetit, në një format të aksesueshëm për publikun.
2. Autoritetet përgjegjëse miratojnë udhëzime të brendshme për zbatimin e këtij vendimi sipas fushave të përgjegjësisë.
3. Vendimi nr. 327 datë 2.06.2021, i Këshillit të Ministrave, "Për mekanizmin e bashkërendimit të punës ndërmjet autoriteteve përgjegjëse, për referimin e rasteve të

dhunës në marrëdhëniet familjare, si dhe procedimin e tij, për mbështetjen dhe rehabilitimin e viktimave të dhunës”, shfuqizohet.

4. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi bashkitë, ministria përgjegjëse për çështjet e barazisë gjinore dhe çështjet sociale, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave, Ministria e Arsimit, Ministrin e Shtetit për Pushtetin Vendor, Ministrin e Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, Policia e Shtetit, si dhe institucionet e tyre të varësisë, sipas fushave të përgjegjësisë.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR

EDI RAMA